

Testimi në klinikën e tuberkulozit

Ju mund ta diskutoni testimin për HIV me doktorin ose infermieren e tuberkulozit, të cilët kanë marrë trajnim të specialituar. I gjithë informacioni trajtohet me fshehtësi. Nëse bëni një test në klinikën e tuberkulozit, rezultati do të regjistrohet në shënimet tuaja të zakonshme të spitalit; kjo do të thotë që rezultati mund të lexohet nga doktorë ose infermiere të tjera që përfshihen në përkujdesjen ndaj jush në spital, por jo nga dikush tjetër.

Testimi në Klinikën tuaj lokale të Mjekësisë Gjenito-Urinare (GUM)

(Për informacion të mëtejshëm, kontaktoni infermieren tuaj të tuberkulozit)

- Në disa klinika, ju mund të hyni dhe të prisni për të bërë një vizitë te doktori; në klinika të tjera, juve mund t'ju duhet të rezervoni një takim
- Ju nuk keni nevojë për një letër nga ndonjë doktor tjetër
- Këto klinika kanë rregulla të veçanta dhe të rrepta për fshehtësinë
- Shënimet tuaja nuk nxirren kurrë nga klinika dhe mund të lexohen vetëm nga personeli që punon atje
- Rezultati nuk do t'i jepet mjekut tuaj të familjes
- Nuk është e nevojshme të jepni emrin tuaj të vërtetë, datën e lindjes ose adresën, por sigurohuni që t'i mbani mend të dhënat personale që keni dhënë
- Nëse dëshironi të kryeni një test në një klinikë tjetër, telefonojini Linjës Kombëtare të Kujdesit ndaj SIDA-s pa pagesë në 0800 567 123
- Ju mund ta merrni testin gjithashtu nga mjeku juaj i familjes
- Sidoqoftë, mjekut tuaj mund t'ju duhet ta kalojë informacionin për një test pozitiv të HIV-it në kompanitë e sigurimit të jetës ose të shëndetit nëse bëni një kërkesë. Nëse jeni të shqetësuar rreth kësaj, do të ishte më mirë të testoheshit në një klinikë GUM.

Mbroni familjen dhe miqtë nga TB - merrni të gjitha ilaçet e TB-së

Burime të tjera këshillash për testimin

National AIDS Helpline (NAH)

Linja Kombëtare e Kujdesit ndaj SIDA-s (NAH)

0800 56 7123

African AIDS Helpline Linja Afrikane e Kujdesit ndaj SIDA-s

0800 0967 500 (faqja e internetit: www.africaninengland.org)

Terrence Higgins Trust Helpline

Linja e Kujdesit e Trustit Terrence Higgins

0845 12 21 200 (faqja e internetit: www.tht.org.uk)

Positively Women Helpline

Linja e Kujdesit ndaj Grave të Konstatuara Pozitive

020 7713 0222 (faqja e internetit: www.positivelywomen.org.uk)

Blackliners Helpline Linja e Kujdesit për Gratë me Ngjyrë

020 7738 5274

Mainliners Helpline Linja e Kujdesit për Përdoruesit e Drogës

020 7582 5434 (faqja e internetit: www.mainliners.org.uk)

TB Alert është një vepër unike bamirësie, që rrit ndërgjegjshmërinë për Tuberkulozin në Mbretërinë e Bashkuar dhe që po mbështet punën e NHS-së, duke ofruar informacione për pacientët. Ne mbështesim projektet në vendet që janë në zhvillim duke siguruar që të gjithë pacientët të marrin trajtimin e duhur. Me mbështetjen tuaj, ne mund të arrijmë një ndikim shumë të madh pozitiv, në mbarë botën për tuberkulozin dhe të shpëtojmë më shumë jetë.



TB Alert,

Community Base,
113 Queens Road,
Brighton BN1 3XG
Tel: 01273 234030

Për informacione të mëtejshme ose për kopje të kësaj broshure, ju lutemi kontaktoni 01273 234 770 (vetëm në orarin zyrtar).

Për të bërë një donacion ose për të dalë vullnetar për të ndihmuar **TB Alert**, ju lutemi kontaktoni 01273 234 784 (vetëm në orarin zyrtar).

Ose vizitoni faqen tonë të internetit në www.tbalert.org

Informacioni i dhënë në këtë broshurë rreth diagnozës dhe trajtimit të tuberkulozit dhe HIV-it ka si synim të japë informacion të përgjithshëm rreth subjektit. Ai nuk mendohet të zëvendësojë njohuritë, ekspertizën, aftësitë dhe gjykimin e mjekëve, farmacistëve dhe/ose profesionistëve të tjerë të shëndetësisë në kujdesin ndaj pacientit. Pyetjet dhe shqetësimet lidhur me diagnozën dhe trajtimin duhet t'i drejtohen një mjeku profesionist të kujdesit shëndetësor.

Punim origjinal kërkimor nga North West London TB Network



Një test i rëndësishëm për njerëzit e prekur nga Tuberkulozi (TB)



Çfarë kanë të përbashkët HIV-i dhe SIDA me tuberkulozin?

Shumica e njerëzve me tuberkuloz në MB nuk janë gjithashtu të infektuar me HIV. Sidoqoftë, HIV/SIDA dhe tuberkulozi mund të shihen shpesh së bashku në disa vende. HIV-i dëmton sistemet mbrojtëse të trupit, që e lejon tuberkulozin t'ju kapë më lehtë.

Disa njerëz e marrin tuberkulozin kur jetojnë në vende të tjera ku si tuberkulozi, ashtu dhe HIV-i janë shumë të zakonshme. Si rrjedhim, këto dy infeksione janë të lidhura ngushtë - çdokush që ka njërin nga këta, mund të jetë i ekspozuar dhe ndaj tjetrit.

Çfarë është HIV/SIDA?

- HIV është shkurtimi i Virusit të Imunodeficiencës Njerëzore. SIDA është shkurtimi i Sindromës së Imuno Deficiencës së Fituar.
- HIV-i është një infeksion që dëmton mbrojtjen e trupit ndaj sëmundjeve të tjera, kryesisht infektive.
- Kur disa sëmundje të tjera të caktuara ndodhin me infeksionin HIV, ai person ka SIDA.

Sa i zakonshëm është HIV-i?

HIV-i gjendet në të gjithë botën. Por ekzistojnë disa zona - si p.sh. Afrika nën-Saharane, Azia Jugore dhe Europa Lindore - ku HIV-i është më i zakonshëm.

Në MB, llogaritet se mbi 30 000 njerëz jetojnë me virusin HIV dhe shifrat vazhdojnë të rriten me më shumë se 6500 njerëz që po testohen pozitivë për virusin HIV për herë të parë çdo vit. Në mbarë botën, mënyra më e zakonshme e transmetimit të virusit HIV është nëpërmjet marrëdhënieve seksuale mes meshkujve dhe femrave, megjithatë numri i rasteve të reja që konstatohen mes meshkujve që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj mbetet i lartë.

A ekziston një kurë për HIV-in ose SIDA-n?

Efektet e HIV-it mund të kontrollohen dhe madje të ndryshohen me anë të ilaçeve kundër HIV-it. Për momentin, nuk ekziston asnjë kurë për HIV-in ose SIDA-n. Megjithatë, studimet tregojnë se shumica e njerëzve që përdorin ilaçe kundër virusit HIV jetojnë më gjatë dhe ndihen më mirë. Nëse ju e dini që jeni bartës i virusit HIV, ju mund të ndërmerreni hapa për të reduktuar rrezikun e kalimit të infeksionit te të tjerët.

Si transmetohet virusi HIV?

- Duke kryer marrëdhënie seksuale vaginale ose anale pa prezervativ. Marrëdhëniet seksuale orale të pambrojtura bartin gjithashtu njëfarë rreziku.
- Nga një nënë te fëmija e saj gjatë shtatzënisë, në lindje ose nëpërmjet ushqimit të gjirit.
- Duke përdorur të njëjtat gjilpëra, shiringa ose mjete të tjera për injektimin e drogës.
- Me anë të trajtimit me gjak ose produkte gjaku jo të testuara.

Testi i HIV-it

Çfarë përfshin testi?

Nga krahu juaj do të merret një mostër e vogël gjaku, do të dërgohet në një laborator dhe do të testohet.

Ju mund të keni bërë teste gjaku më parë në klinikë, por ne mund të bëjmë një test për HIV-n vetëm me pëlqimin dhe autorizimin tuaj. Të gjitha testet për HIV-in janë pa pagesë.

Sa duhet të pres për të marrë rezultatin?

Zakonisht, për të marrë rezultatet duhen 3 ditë pune. Cilido që të jetë rezultati, ai do t'ju jepet personalisht nga një profesionist i shëndetësisë: rezultati nuk mund të jepet nëpërmjet telefonit dhe kopjet e rezultatit në letër zakonisht nuk u jepen pacientëve.

Çfarë do të thotë rezultati?

Negativ ndaj HIV-it

Kjo do të thotë se ju nuk keni HIV, përveç rastit nëse jeni ekspozuar ndaj këtij virusi brenda 3 muajve përpara testit. Nëse jeni ekspozuar në 3 muajt e fundit, testi mund të mos jetë në gjendje ta konstatojë këtë (periudha e "dritares"). Juve mund t'ju këshillohet të kryeni një test tjetër 3 muaj pas rrezikut më të fundit të ekspozimit ndaj virusit HIV.

Pozitiv ndaj HIV-it

Ju bartni virusin HIV. Rezultati verifikohet me anë të një testi të dytë për virusin HIV (gabimet kanë pak gjasa të ndodhin). Jo do të bëni një takim konfidencial me një specialist në HIV/ SIDA, do t'ju mbështesin të gjeni diagnozën dhe të planifikoni ndonjë trajtim që kërkohet.

Kujt i komunikohet rezultati?

Rezultati është vetëm për ju dhe për personelin që merret me kujdesin tuaj mjekësor. Askush tjetër nuk do e marrë vesh rezultatin pa autorizimin tuaj. Rezultati nuk i jepet partnerit tuaj, dikujt tjetër në familje ose shoqërisë, punëdhënësit tuaj, qiramarrësit tuaj, qeverisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme ose Shërbimit të Emigracionit.

Ku mund të shkoj për të kryer një test për HIV-in ose për të diskutuar për testimin?

Ju mund ta bëni testin në klinikën e tuberkulozit, por gjithashtu ekzistojnë edhe vende të tjera ku ju mund të bëni një test ose të diskutoni për çdo problem që mund të keni.